



VENDIM

Nr. 59 Datë 18.04.2017

**MBI
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE BAZË TË TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 22, 51 dhe 97 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, pikat 1 dhe 2 të VKM nr.519 datë 13.07.2016 "*Për Miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike*", nenit 15 të “*Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016 dhe rekomandimet nga Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 18.04.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.04. 2017, pasi shqyrtoi relacionin në lidhje me hartimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike.

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative.

brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare .

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE
Petrit AHMETI**